



Agro & Social Fund
sh.p.k



RAPORT VJETOR 2021

www.asf.al

PËRMBAJTJA

Historiku Institucional	02
Rrjeti i degëve	03
Misioni & Vlerat Thelbësore	04
Mesazhi nga Drejtori Ekzekutiv	05
Sfidat dhe Arritjet 2021	06
Arritjet në kredidhënie	08
Menaxhimi i Portofolit në Risk	10
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	11
Marketingu	13
Performanca Sociale	14
Klientët Tanë	16
Raporti I Auditorëve të Pavarur	17
Bilanci	18
Pasqyra e të ardhurave	19
Pasqyra e flukseve të parasë	20
Bashkëpunëtorët tanë	21

HISTORIKU INSTITUCIONAL

E deri më tani

Fondi Besa është pronari dhe Ortaku i Vetëm i këtij institucioni me zotërimin e 100% të aksioneve.

DHJETOR
2016

NENTOR
2016

VisionFund International vendos tërheqjen e përfqësisë së tyre nga Shqipëria, kështu që në muajin Dhjetor 2016, u arrit marrëveshja e shitjes së Institucionit tek **Fondi Besa sh.a**, institucioni financiar jobankar më i madh në Shqipëri.

Kalon Institucion
Mikro- financiar me status ligjor
“Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar”
- **Vision Fund Albania**.

Në pronësi dhe kontroll 100% të
VisionFund International degë e
World Vision International.

DHJETOR
2009



**AGRO &
SOCIAL FUND**
mori licencën nga
Banka e Shqipërisë
Nr. 17, si Institucion
Financiar i
Mikrokredisë.

2009

Krijohet “Building Future”
Krijohet “Building Future” si
program mikrofinanciar i
World Vision Albania,
fillimisht me hapjen e zyrës
së parë në rajonin e Lezhës.

2001

RRJETI I DEGËVE TË AGRO & SOCIAL FUND



MISIONI I AGRO & SOCIAL FUND

“Agro & Social Fund mbështet zhvillimin e qëndrueshëm, përfshirjen financiare dhe kohezionin social, nëpërmjet asistencës së përgjegjshme financiare , kryesisht të ndërmarrjeve mikro e të vogla dhe individëve, me qëllim lehtësimin e përmirësimit e jetesës , zgjerimin e oportuniteteve për sipërmarrje e punësim në komunitete si gra, të rinj, apo grupe të ndryshme vulnerabël, me fokus zonat rurale e semi-urbane. “

VLERAT E AGRO & SOCIAL FUND

Agro & Social Fund është i fokusuar në përmirësimin e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve që i ofrohen klientelës së synuar, kryesisht nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm të kërkesave të tyre, krijimit të mundësive për klientët, familjet dhe komunitetet në rritjen e mirqënies, uljen e varfërisë apo vulnerabilitetit, rritjes së aksesit në financë, krijimit të vendeve të reja të punës apo dhe shtimit të vlerës së atyre ekzistuese.

Në rrugëtimin tonë të udhëhequr nga misioni, ne ruajmë e pasurojmë vlerat tona.

Ne përpiqemi t'i shfrytëzojmë këto vlera me qëllimin që të sigurojmë punonjës të motivuar dhe të orientuar drejt rritjes së rezultateve dhe mbrojtjen nga devijimi i misionit, punonjës që do arrijnë të zhvillohen e veprojnë në sintoni të plotë me linjën për rritjen e objektivave të institucionit.



Ne jemi të përkushtuar për të punuar pranë njerëzve, me qëllim nxitjen e përmirësimit të jetës së tyre.



Ne jemi besnikë ndaj qëllimit dhe të përgjegjshëm për burimet që na janë besuar, du ki menaxhuar ato në mënyrë të tillë që të sjellin kthimin maksimal për kompaninë dhe klientët tanë.



Ne vlerësojmë njerëzit, konsiderojmë të barabartë dhe u japim atyre përparësi atyre përkundërt fitimit e qëllimve tradicionale të biznesit, strukturave e sistemeve.



Ne jemi punonjës dhe një kompani e besuar në treg – ajo e cila qëndron për integritetin dhe vendos një standard për të, duke frymëzuar të tjerët të jenë gjithmonë të besueshëm dhe të ndershëm



Ne vlerësojmë e promovojmë transparencën dhe sjelljen etike

DREJTORI EKZEKUTIV (Agro & Social Fund sh.p.k)



Të nderuar klientë, partnerë, punonjës dhe bashkëpunorë,

Në nisje të vitit 2021, secili prej nesh ishte skeptik për objektivat, mundësitë për arritje, rolin e tij; më afër ndjente dështimin e me shumë dyshim shpresonte suksesin. Çdo gjë kishte ndryshuar pas pandemisë së COVID-19 dhe gjithëkush do të gjendej në vështirësi pas saj, për të kuptuar rrugën që duhej të ndiqte, ku mbijetësa ishte kryefjala.

Por çdo ditë, me punën e gjithësecilit anëtar të kësaj familje, me dëshirën dhe besimin për të bërë më të mirën, shtruam rrugën tonë të shpëtimit dhe zhvillimit dhe rifituam aftësinë për të planifikuar rritjen. Ne arritëm të forcojmë marrëdhënien tonë me klientët, ndërtuam ura të reja bashkëpunimi dhe fituam partnerë të rinj, përmbushëm angazhimet tona ndaj partnerëve tradicionalë duke ju treguar se bashkëpunimi ynë vlen dhe duhet të konsolidohet. Ne rritëm praninë tonë në territor dhe shtuam produktet financiare. Ne shtuam familjen tonë me punonjës të rinj dhe konsoliduam mundësitë që të zhvillojmë politika shpërblimi për çdo individ – pjesë e stafit tonë.

Gjatë vitit 2021, portofoli i kredisë shënoi një rritje prej 14.2 % krahasuar me një vit më parë duke arritur në rreth 877 milion lekë. Ju shërbyem cilësisht 2,133 klientëve, të cilët disbursuan rreth 700 milion lekë. Ne jemi krenarë që gjatë vitit 2021 mundësuam përmirësimin e cilësisë së jetës në mënyrë indirekte të rreth 4,900 fëmijëve, ndikuam në përmirësimin e cilësisë së jetës të 224 klientëve nga grupet e marginalizuara dhe ju krijuam mundësinë 241 të tjerëve të ishin sipërmarrës të një biznesi për herë të parë. Siguroam që 62% e totalit të klientëve të jenë të përqëndruar në zonat rurale dhe 50 % e numrit të klientëve të ishin kliente femra.

Gjatë këtij viti, siguroam gjithashtu mbështetjen e Frankfurt School – FS (linje kredie) dhe Rural Credit Guarantee Foundation (RCGF, sot ADGF me skemë garancie), si dhe dy bankave të nivelit të dytë, duke përmirësuar procesin e sigurimit të fondeve të reja; rritur fashen e besimit dhe bashkëpunimit me institucione të rëndësishme financiare në nivel kombëtar e ndërkombëtar, duke e vendosur institucionin tonë tashmë në një tjetër nivel negocimi e pranimi. Në gjithë rrugëtimin e gjatë një vjeçar të 2021-shit, në patëm mbështetjen e EaSI dhe SwissContact nëpërmjet asistencës teknike të vendosur në dispozicion, kryesisht jetësuar në trajnime.

Duke falenderuar çdo klient që vendosi të bashkëpunojë me ne, çdo partner e huadhënës që na besoi dhe duke falënderuar mbi të gjitha çdo anëtar të stafit të Agro & Social Fund për kontributin e paçmuar, dëshiroj të konfirmoj angazhimin në vazhdimësi për të përmbushur objektivat tona që lidhen me nxitjen e sipërmarrjes, nxitjen e punësimit e në veçanti punësimit

të të rinjve, grave dhe shtresave të marginalizuara, uljen e varfërisë dhe zhvillimin lokal dhe të qëndrueshëm.

Faleminderit!

Rozana OROZI
Drejtore Ekzekutive

SFIDAT & ARRITJET 2021

Pavarësisht kushteve të vështira, nën të cilat iu desh të zhvillonte aktivitetin e tij, Agro & Social Fund vijoi funksionin në zbatim të misionit dhe objektivave të përcaktuara.

Pasojat e pandemisë vazhduan të ishin prezente, kryesisht me intensitet më të lartë gjatë gjysmës së parë të vitit, por që patën shtrirje edhe në pjesën e mbetur. Konteksti në të cilën u desh të punonim, pati vështirësi të mbartuara e të shtuara si pasojë e një pandemie që zgjati me shumë seç pritej. Pavarësisht të gjithave, viti 2021 ishte një vit i suksesshëm për Agro & Social Fund, ku arritëm për herë të parë të lidhnim marrëveshje me një partner ndërkombëtar dhe gjithashtu finalizuam dy marrëveshje të tjera me banka të nivelit të dytë. Viti 2021 rezultoi të ishte një vit i suksesshëm për Agro & Social Fund, ku arritëm të siguronim rezultatin më të kënaqshëm financiar në historikun e veprimtarisë së deritanishme.

- Administruam një portofol prej rreth 877mln lekë. Në shifra kumulative përgjatë këtyre viteve ju është shërbyer rreth 28,717 klientëve, duke disbursuar rreth 5.5 mld Lekë.
- Agro & Social Fund, ndër vite paraqitet me një trend pozitiv të rritjes së portofolit: 59% (2018), 28% (2019), 19.3% (2020) dhe 14% (2021).
- Në mbyllje të vitit 2021, 62% e klientëve i përkisnin zonave rurale dhe 50% kliente femra.
- Një staf prej 81 punonjësish ishte në shërbim të 3,128 klientësh
Retention RATE (Raporti i Ruajtjes së Klientelës) 74%.
Nga të dhënat e mbledhura rezultojnë që me financimet tona, kemi ndikuar jetën e rreth 4950 fëmijëve, në mënyrë direkte apo indirekte.
- Në 5 vite ASF, zgjerimi i zonave që institucioni ynë mbulon me shërbime ka ardhur në rritje, nga 6 zyra në vitin 2017, mbyllja e vitit 2021 na gjeti me 12 zyra.
- Gjatë vitit 2021, Agro & Social Fund në përmbajtje të planit të zgjerimit, hapi Degën Rajonale Durrës, duke shtrirë kështu shërbimet dhe aktivitetin tonë edhe në këtë qytet.
- Finalizuar projektin “Përmirësimi i sigurisë dhe administrimit të komunikimit dhe informacionit – ngritja e sistemit VPN dhe sistemit Closed Circuit Television për Agro&Social Fund sh.p.k”, Ky projekt kishte synimin kryesor vendosjen e komunikimit dhe administrimit të informacionit në nivele shumë më të përmirësuara sigurie, në perputhje me kërkesat koherente të rregullatorëve dhe ligjit, por dhe nevojave që sjell rritja e Institucionit.
- Viti 2021 pati në fokus zgjerimin e partneriteteve me ortakë kombëtar e ndërkombëtar. Ishte një periudhë intensive me dërgim informacioni, kryqëzim të dhënash, dhe u zhvilluan disa procese due-diligence me:

- Frankfurt School Finance;
- Albanian Development Guarantee Foundation (që më përpara njihet me emrin Rural Credit Guarantee Foundation);
- Union Bank; - BKT; - European Investment Fund;

Me katër partnerët e parë u nënshkruan marrëveshjet ndërsa nga European Investment Fund në fund të muajit Tetor u lajmëruam për aprovimin e kredisë nga bordi i tyre, në shumën 1 mln euro dhe jemi në komunikim dhe ndërveprim mbi draftin përfundimtar të kontratës që pritet të nënshkruhet brenda muajit Janar 2022.

- Ka vijuar ngritja e fondeve me partnerin KIVA (vlerësuar për shkak të fee-ve të ulta të fondeve sipas kategorive) ku krahasimisht me fund vitin 2020 portofoli Kiva është rritur me rreth 9%. Përmbledhtazi, mund të themi që kjo ishte një fushatë frytdhënëse përse i përket synimeve që kishim dhe rezultateve të përfutuara.

Çertifikimi “Code of Good Conduct”

Agro & Social Fund përmbylli me sukses procesin 18 mujor të vlerësimit të praktikave institucionale, due diligence, për “Code of Good Conduct”. Prej Mars 2021 “posedojmë” Çertifikatën për përputhje me Kodin e Sjelljes Mirë, në nivelin e përputhshmërisë 93%. Falë këtij çertifikimi, që promovon standartet e larta në mikrofinancë, ASF ka adaptuar praktika të përgjegjshme dhe etike me një orientim të qartë përkundrejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Në datat 14-15 Tetor 2021, u zhvillua konferenca e 18-të e European Microfinance Network (EMN), në të cilën ASF u përfaqësua nga Drejtuesja Ekzekutive, Znj. Rozana Orozi. Konferenca në fjalë u mbyll me Ceremoninë e dhënies së çertifikatave “Code of Good Conduct”, me prezencën e Ann Branch - Head of Unit for Job Creation in the EC's DG EMPL.



ARRITJET NË KREDIDHËNIE



Rritja e volumit të kredive Aktive në Numër me **340 klientë** dhe **109 milion** në Vlerë, respektivisht me **12,2%** dhe **14,2%**, për vitin 2021, ndërsa si periudhë 5-vjecare, kreditë aktive janë rritur me 88% në numër dhe 172% në vlerë.



Rritja e volumit të Disbursimit në Numër **320 klientë** dhe **131 milion** në Vlerë respektivisht me **17,7%** dhe **23,3%**, për vitin 2021.



Rritja e volumit Kumulativ në Numër me **2133 klientë** dhe me **695 milion** në Vlerë respektivisht **8%** dhe **14%**, për vitin 2021, ndërsa si periudhë 5-vjecare, ato janë rritur me 36% në numër dhe 73% në vlerë.

2021	Nr.	Vlerë
Kredi të Disbursuara	2133	695,319,053
Portofol Aktiv	3128	877,200,408
Kredi Rurale	1317	415,574,588
Klientë Vulnerabël	224	63,540,000
Klientë të Rinj	49 %	45 %
Kliente Femra	48 %	46 %

	Kredi të Disbursuara në Nr.	Kredi te Disbursuara në Vlerë (mln lekë)	Kredi Aktive në Numër	Portofol Outstanding (mln lekë)
2017	1,211	304	1662	322
2018	1861	514	2,195	503
2019	1,779	556	2,509	643
2020	1,813	564	2,788	768
2021	2,133	695	3,128	877

Disbursime Kumulative



PRODUKTET TONA TË KREDISË

Një risi gjatë vitit 2021 ishte lançimi i nënproduktit FAST, i cili duke patur specifika lehtësuese si lëvrimi i kredisë brenda 3 orëve, pa garantor dhe miratim në nivel Dege, bëri që ky produkt të zerë 2% te vlerës së portofolit aktiv dhe 4% të vlerës së kredive të disbursuara përgjatë vitit.

TË RINJTË SIPËRMARRËS

SHUMA DERI NË 400,000 LEKË.
AFATI DERI NË 48 MUAJ
INTERESI PËRCAKTOHET NGA
SHUMA E KREDISË

EFIÇENSA E ENERGJISË

SHUMA DERI NË 1,000,000 LEKË.
AFATI DERI NË 60 MUAJ
INTERESI PËRCAKTOHET NGA
SHUMA E KREDISË

KREDI BIZNESI

SHUMA DERI NË 2,000,000 LEKË.
AFATI DERI NË 72 MUAJ
INTERESI PËRCAKTOHET NGA
SHUMA E KREDISË

KREDIA KONSUMATORE

SHUMA DERI NË 500,000 LEKË.
AFATI DERI NË 48 MUAJ
INTERESI PËRCAKTOHET NGA
SHUMA E KREDISË

KREDI AGRO

SHUMA DERI NË 2,000,000 LEKË.
AFATI DERI NË 84 MUAJ
INTERESI PËRCAKTOHET NGA
SHUMA E KREDISË

KREDIA SOCIALE

SHUMA DERI NË 500,000 LEKË.
AFATI DERI NË 36 MUAJ
INTERESI PËRCAKTOHET NGA
SHUMA E KREDISË

START-UP

SHUMA DERI NË 500,000 LEKË.
AFATI DERI NË 48 MUAJ
INTERESI PËRCAKTOHET NGA
SHUMA E KREDISË

GRUAJA RURALE


SHUMA DERI NË 300,000 LEKË.
AFATI DERI NË 36 MUAJ
INTERESI PËRCAKTOHET NGA
SHUMA E KREDISË

NËN-PRODUKTI FAST

SHUMA DERI NË 100,000 LEKË.
AFATI DERI NË 12 MUAJ
LËVRIM BRENDË 3 ORËVE, PA
GARANTOR

Një tjetër arritje e kënaqshme në treguesit e këtij viti është performanca e produktit Biznes, i cili përbën 28% të Portofolit Aktiv, i ndjekur nga produkti Eficenca e Energjisë me 25%.


Shpërndarja e Portofolit sipas Produkteve




MENAXHIMI I PORTOFOLIT NË RISK

Në mbyllje të vitit 2021, portofoli në risk i ASF- është 4.57%.

Gjatë këtij viti produktet me peshë në risk mbajnë thuajse të njëjtat pesha në totalin e portofolit aktiv, e cila tregon se kemi të bëjmë me një shpërndarje të drejtë të riskut sipas peshës në portofol të secilit produkt.



ASF, në mbyllje të vitit 2021 pati një përmirësim të ndjeshëm të treguesit PAR > 30 ditë, krahasuar me 6 – mujorin e parë të vitit





MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Agro & Social Fund sh.p.k. ndër vite e kanë shoqëruar ndryshime dinamike, përmirësime të vazhdueshme të proceseve dhe proceduarave kredituese.

Gjatë vitit 2021, ASF punoi për të çuar përpara të gjitha perspektivat e rritjes së saj, të nisura dhe më parë, në vitin pandemik, për t'u rritur e për të arritur sukseset e radhës.

Në 5 vite ASF kemi zgjeruar aktivitetin tonë nga 6 zyra në vitin 2017, në 12 zyra në mbyllje të vitit 2021. Në 15 Nëntor 2021 u hap Dega Rajonale Durrës. (foto e inagurimit të Durrësit).



Numri i punonjësve në mbyllje të vitit 2021 në ASF: 81



Trajnimet e stafit

Ky vit i lënë pas ka qenë një vit intensiv për ASF në ofrimin e trajnimeve për stafin e saj.

Me qëllim që të kemi një performancë sa më të suksesshme të stafit, për të qenë më eficientë dhe të kualifikuar, rritëm intensitetin e trajnimeve në 148% krahasuar me 1 vit më parë.

Trajnimet që ASF ofron për stafin diferencojnë në sajë të viteve të punësimit dhe nevojave individuale të gjithësecilit punonjës. Seria e trajnimeve që ofrohen gjatë një viti nis me trajnimin e orientimit për stafin e ri dhe vazhdon me trajnime për rritje të aftësive profesionale, të cilat ofrohen si nga stafi manaxherial i ASF-së, ashtu dhe nga bashkëpunëtorë të jashtëm si p.sh: Microfinance Centre dhe EaSI, Swiscontact në bashkëpunim me Partners Albania.

Trajnime të përfituara nga Asistenca teknike e EaSI-t gjatë vitit 2021:



brenda janarit 2021, stafi i departamentve të Zyrës Qendrore morën pjesë në trajnime që kishin fokus përmirësimin dhe zhvillimin e njohurive të mëtejshme mbi çështje specifike të departamentit përkatës;



brenda shkurtit 2021, u zhvilluan trajnime që përfshinë pothuaj të gjithë stafin në degë, me fokus rritjen e njohurive mbi:

1. Shitjen dhe marketingun
2. Analizën financiare.



MARKETING 2021

Gjatë vitit 2021 efektet mbartëse të pandemisë vijuan të ishin prezente. Pavarësisht të gjitha masave shtrënguese për pjesën më të madhe të vitit, stafi i Agro & Social Fund, duke qënë të kujdesshëm në mbrojtje të shëndetit të gjithësecilit, rritën sinjifikativisht marketingun fizik, krahasuar me një vit më parë. Forma tradicionale e marketingut, vijoi të ishte e ndërthurur me marketingun online, formë e cila shihet si një element shumë i rëndësishëm për tu zhvilluar në vitet në vazhdim. Gjatë viteve të fundit, janë hedhur themelet e ngritjes së një marketingu të mirëfilltë digjital, duke e parë atë si një ndër elementët kyç në zgjerimin e mëtejshëm të aktivitetit të Agro & Social Fund.

Përgjatë 2021-it, nga marketingu fizik i zhvilluar nga secila degë e institucionit u arritën rreth 5,000 klientë. Sa i takon këtij lloji marketingu degët, përveç takimeve individuale me klientë potencialë, kanë shfrytëzuar aktivitete të ndryshme lokale me qëllim arritjen e më shumë individëve njëkohësisht; ku mund të përmendim Panairin e Devollit, Panairin “Tirana Agro 100”, etj.

Faqja jonë e web-it dhe rrjetet tona sociale, shënuan rritje në kurbën e tyre përgjatë vitit 2021, në numër ndjekësish, pëlqimesh e ndërveprimesh gjë e cila do të vazhdojë të rritet pasi ne e konsiderojmë prezencën tonë online si një mundësi për të qënë më afër nevojave të klientëve tanë.



PERFORMANCA SOCIALE

Ngjarjet e ndodhura gjatë dy viteve të fundit, tërmeti i 2019 dhe pandemia globale e Covid-19 padyshim që shtrinë efektet e tyre edhe përgjatë vitit 2021. Edhe pse në nivele më të ulëta, pati sërish vështirësi dhe kufizime të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikuan në mbarëvajtjen institucionale. Gjithsesi, pavarësisht rrethanave, stafi i Agro & Social Fund, tregoi angazhim maksimal përgjatë gjithë vitit, për përmbushjen e detyrave që vijnë si rrjedhojë e misionit dhe e objektivave kryesore të institucionit. Edhe këtë vit, ne ia dolëm me sukses: **Qëndruam** sërish afër grupeve të cilat kanë nevojë për suportin tonë financiar. **Ruajtëm dhe konsoliduam** marrëdhëniet me klientelën ekzistuese dhe zgjeruam bazën e klientelës aktive. U **angazhuam** dhe patëm sukses në vendosjen e kontakteve dhe lidhjen e kontratave me partnerë të rinj, vendas dhe ndërkombëtarë. Në mbyllje të vitit 2021, mund të themi që Agro & Social Fund, pati një vit të suksesshëm, pavarësisht sfidave dhe vështirësive që hasëm

Agro & Social Fund është plotësisht i përkushtuar ndaj Standardeve Universale për Menaxhimin e Performancës. Qasja jonë proaktive ndaj përgjegjësisë sociale arrihet përmes iniciativave të ndryshme sociale që synojnë komunitetet lokale dhe individët e marginalizuar, dhe duke përdorur tregues dhe mjete të ndryshme si; rezultatet e mirëqenies së fëmijëve, përgjegjësia e politikave dhe mjedisit, mjetet e matjes së varfërisë, pyetësorët mbi kënaqësinë e klientit, që na mundësojnë monitorimin e ndikimit tonë social dhe mjedisor.



Treguesit dhe arritjet kryesore për vitin 2021:

51% huamarrëse femra të disbursuara
62% klientë rural të disbursuar
300 biznese të reja të krijuara
180 klientë vulnerabël nga grupet e marginalizuara
4,950 fëmijëve ju është impaktuar jetesa.
3,900 vende pune të ruajtura



ASF vepron në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG). Në terma të përgjithshëm, aktiviteti i ASF ka një ndikim, në shkallë të ndryshme, në trembëdhjetë SDG.

Projekte



Është një organizatë ndërkombëtare jofitimprurëse, e themeluar në vitin 2005 me mision për të lidhur e afruar njerëzit nëpërmjet huadhënies dhe për të lehtësuar varfërinë. Kiva synon të ofrojë mundësi për huamarrës në gjithë botën, veçanërisht vendet në zhvillim, përfshirë Shqipërinë. Prej më shumë se një decade, Agro & Social Fund vazhdon partneritetin me Kiva-n, ku edhe përgjatë vitit 2021 rezultoi të ishte një bashkëpunim i suksesshëm, që u përmbyll me:



652-kredi të financuara në Kiva të cilat ndihmojnë njerëzit të krijojnë mundësi për vete dhe komunitet ku jetojnë



\$1,244,750.00-financime në Kiva për të ndihmuar njerëzit të përmirësojnë jetën e tyre dhe të familjeve të tyre.

Fushata Borrow Wisely

Për të tretin vit rradhazi ASF i'u bashkua fushatës ndërkombëtare "Borrow Wisely"!

Përgatitja për pjesëmarrje në Fushatën Huamarrje e Zgjuar nisi që në muajin Shtator me trajnimin e stafit, të cilët gjatë gjithë muajit Tetor 2021, specifikisht, u angazhuan për të informuar dhe këshilluar klientët se si të bëjnë Huamarrje të Zgjuar. Prezenca jonë ishte e ndërthurur me praninë online dhe atë fizike, duke qenë të kujdesshëm në respektimin e të gjitha masave të nevojshme mbi sigurinë shëndetësore.

Në faqen tonë të web-it, vendosëm në dispozicion të klientëve një hapsirë të dedikuar për fushatën Huamarrje e Zgjuar.

Metodat e përvetësuara gjatë kësaj fushate vazhdojnë të përdoren nga stafi ynë kundrejt klientëve, me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor dhe krijimin e standarteve në kredidhenie, ku ndër më kryesoret mbetet informimi dhe transparenca ndaj klientit.



Programi tre vjeçar "NXITJA E SIPËRMARRJES NË RAJONIN E TROPOJËS NËPËRMJET KREDITIMIT" me partnerë DORCAS ALBANIA, Agro & Social Fund dhe Shoqata "Integrim Tropoja" vijoi me zbatimin e tij përgjatë vitit 2021 në zonën e Tropojës. Lidhur me të gjitha fushat e ndërhyrjes në fokus mbetet promovimi i rolit ekonomik të grave, barazia gjinore, fuqizimi i grave dhe avokimi për shërbimin e duhur publik.



Në bashkëpunim me Swisscontact, Agro & Social Fund mbështet sipërmarrës të rinj dhe ekzistues (pjesëmarrës të cikleve të ndryshme të trajnimeve që ofron ky bashkëpunim), për të financuar aktivitetet e tyre të vetëpunësimit.



KLIENTËT TANË



Altjon Voci

Njihuni me Altjonin. Djalini 36 vjeçar, baba të dy fëmijëve dhe sipërmarrës i suksesshëm nga qyteti i Lezhës. Altjoni mori kredinë e parë në ASF në vitin 2019 për të blerë inventar për punën e tij si hidraulik. Në atë kohë Altjoni ofronte vetëm shërbime hidraulike së bashku me vëllain e tij. Sot, në kredinë e katërt me ASF, Altjoni ka në menaxhim 2 dyqane, njërin në Lezhë dhe tjetrin në Shëngjin, ku ofron produkte hidraulike; 4 punëtorë të përhershëm, me të cilët ofron shërbime hidraulike në të gjitha zonat përreth Lezhës; si dhe disa punëtorë të tjerë sezonal, kryesisht për sezonin e verës. “Une do t’i rekomandoja gjithëkujt që ka një ide dhe një pasion që të kërkojë për mjete financimi! Është e sigurt që nëse bën punën që dëshiron do të jesh i suksesshëm!” – tha Altjoni gjatë intervistës!



Ares Zefi

Ares është vetëm 24 vjeç dhe ka tashmë 2 vite që punon si shef kuzhine për një restorant të famshëm në zonën e Shëngjinit. Vetëm para pak kohësh Ares aplikoi për kredinë e parë në ASF për të hapur një pastiçeri në Shëngjin. “U bënë disa vite që mendoj të hap një pastiçeri. Doja ta hapja fiks përpara sezonit veror pasi gjatë kësaj periudhe pastiçeritë kanë pikun e aktivitetit të tyre. Mirëpo, asnjëherë nuk arrija të kurseja mjaftueshëm për të realizuar investimin që unë dëshiroja. Këtë vit vendosa që të marr një kredi pranë ASF. Faleminderit stafit për ndihmën e ofruar për të kuptuar më shumë rreth kredive dhe bizneseve start-up! Jam i sigurt që kam bërë zgjedhjen e duhur për realizimin e ëndrrës time dhe se do të arrij të paguaj në kohë të gjitha këstet e kredisë!” – tha Ares gjatë një interviste.

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR



Ernst & Young Certified Auditors
Albania Branch
NOLIS: K619110121
Breshëm Rugovës Str. Sky Tower, 6th floor
1001, Tirana, Albania

Tel: +35542415575
ey.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin e Agro & Social Fund sh.p.k.

Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Agro & Social Fund sh.p.k. (më poshtë "Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirë, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksve monetare për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe fluksve të parasë për vitin e mbyllur më atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilitetit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbytur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera të Përfshira në Raportin Vjetor 2021 të Agro & Social Fund sh.p.k.

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Shoqërisë për vitin 2021, përgatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Shoqërisë për vitin 2021 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë iloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalië mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomaliës materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rrezeqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përshtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpejtimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Agro & Social Fund sh.p.k., përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar

Dega në Shqipëri

Ernst & Young Certified Auditors

24 qershor 2022

Tiranë, Shqipëri



Mario Vanjel

Auditues Ligjor

Mario Vanjel

BILANCI

	(Shumat në mijë Lek)	
	2021	2020
Aktivet		
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	120,380	51,205
Hua dhe paradhënie për klientët	830,119	736,117
Aktivet afatgjata materiale	14,035	15,014
Aktive të tjera	3,698	10,710
Të drejtat mbi Asetet	45,714	45,769
Totali i aktiveve	1,013,946	858,814
Detyrimet dhe Kapitali i vet		
Detyrimet		
Huate	622,126	515,141
Detyrimet mbi Qeratë	46,533	46,661
Detyrime të tjera	24,245	16,126
	692,903	577,928
Kapitali i vet		
Kapitali aksionar	289,375	289,375
Humbje të mbartura	(8,488)	(29,147)
Fitimi i vitit	40,156	20,658
	321,043	280,886
Totali i detyrimeve dhe Kapitali i vet	1,013,946	858,814

PASQYRA E TË ARDHURAVE

	(Shumat në mijë Lekë)	
	2021	2020
Interesa		
Të ardhura nga interesi	221,519	184,982
Shpenzime për interesa	(36,084)	(30,015)
Të ardhura neto nga interesi	185,435	154,967
Të ardhura/(Shpenzime) të tjera	1,652	1,481
Detyrimet dhe Kapitali i vet		
Shpenzime operative		
Zhvlerësimi	(17,483)	(17,204)
Shpenzime personeli	(85,177)	(77,104)
Humbje nga zhvlerësimi i huave	(23,140)	(20,050)
Shpenzime të tjera	(17,300)	(17,000)
Fitim/(humbje) neto nga kurset e këmbimit	4,929	(66)
Totali i shpenzimeve operative	(138,172)	(131,424)
Fitim/(humbja) përpara tatimit	48,916	25,024
Tatim fitimi	(8,760)	(4,366)
Fitim/(humbja) për vitin	40,156	20,658
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, pas tatimit	-	-
Totali i të ardhurave/(humbjes) gjithëpërfshirëse për vitin	40,156	20,658

PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË

	në mijë Lekë)	
	2021	2020
Flukset monetare nga aktivitete operacionale		
Fitimi / (Humbja) për vitin	31,395	25,024
<i>Korrigjime për:</i>		
Zhvlerësimi	3,714	4,174
Zhvlerësimi në Të drejtat mbi Asetet	13,769	13,030
Pakësime neto në Aktivet Afatgjata	-	-
Humbje nga zhvlerësimi i huave	23,140	20,050
Të ardhura nga interesi	(221,519)	(184,982)
Shpenzime për interesa	37,061	30,015
<i>Ndryshime në:</i>		
Hua dhe paradhënie për klientët	(119,663)	(124,015)
Aktive të tjera	20,793	(8,893)
Detyrime të tjera	8,119	(1,064)
	(202,637)	(226,661)
Interesi i arkëtuar		
Interesi i paguar	(40,080)	(36,950)
Tatimi mbi të ardhurat i paguar	(5,022)	4,967
Flukset monetare nga / (të përdorura) në aktivitete operacionale	(23,699)	(82,289)
(Shtesa)/ pakësime neto në aktivet afatgjata materiale	(2,735)	(1,374)
Flukset monetare përdorur në aktivitete investuese	(2,735)	(1,374)
Flukset monetare nga aktivitete financuese		
Fonde të (paguara)/ marra si hua dhe qira financiare	110,819	84,533
Pagesa në Detyrimet mbi Qeratë	(15,210)	(12,555)
Flukset monetare përdorur në aktivitete financuese	95,610	71,978
Rritja/ (rënia) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente me to	69,175	(11,685)
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to në fillim të vitit	51,205	62,890
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to në fund të vitit	120,380	51,205

BASHKËPUNETORËT TANË







KONTAKTET TONA:



www.asf.al



Agro Social Fund



Agro & Social Fund



[agrosocialfund_shpk](https://www.instagram.com/agrosocialfund_shpk)

info@asfund.org

+355 46 31 57 43

Rruga "Nikolla Lena" Hyrja 1, Ap.25

